



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

Kryesues i Senatit
Prof. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 2850 Dt 10.11.2022

Në bazë të nenit 49, paragrafi 1, nënparagrafi 9, si dhe duke pasur për bazë nenin 135,136 dhe 137 të Statutit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 29.09.2022, mori:

VENDIM

1. Aprovohet plotësimi i Rregullores për transferim të studimeve në Universitetin "Isa Boletini", në Mitrovicë.
2. Pjesë e këtij vendimi është Rregullorja për transferim të studimeve në Universitetin "Isa Boletini", në Mitrovicë.
3. Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit në Senat.

Vendimi i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Menaxhmentit.
3. Fakulteteve
4. Zyrës për komunikim me publikun

Prof. dr. Alush Musaj

Kryesues i Senatit të UIBM




**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

Nr. Prot. 2850 Dt. 10.11.2022

Mbështetur në kompetencat e përcaktuara me nenin 49, paragrafi 1, nënparagrafi 9, si dhe duke pasur për bazë nenin 135, 136 dhe 137 të Statutit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, Senati i Universitetit, në mbledhjen e datës 29.09.2022, miraton këtë:

Plotësim i Rregullores për transferim të studimeve Nr. 1668 dt. 28.09.2021

Neni 1.

Në nenin 3, paragrafi 3, nënpika 3 të Rregullores, shtohet nënpikja 3.3.1. me këtë tekst "Përjashtimisht në rastet kur ndryshimi i kredive është vetëm 1 kredi [25 orë], kur përmbajtja e lëndëve është sikur e prezantuar në pikën 1 të nenit 3, profesori i lëndës ka të drejtë të ngarkojë studentin me një aktivitet akademik për të mbuluar diferencën prej 1 kredie.

Neni 2.

Plotësimi i Rregullores për transferim të studimeve Nr. 1668 dt. 28.09.2021, hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Senati i Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë.


Prof. dr. Alush Musaj
Rektor
